

# Raport Vjetor 2008



## **Raport Vjetor 2008**

### **MISIONI**

Promovim të shanseve të barabarta dhe mbrojtje të vazhdueshme të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Design & Layout: Orest Muça

© Copyright FSHDPAK

Për më tepër informacion kontaktoni:

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga BOGDANI, P.15, Kati i 3-të, Tiranë

Tel/Fax: + 355 42 269 426

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

e-mail: [adrf@albmail.com](mailto:adrf@albmail.com)

## Përschëndetje

Në cilësinë e Drejtueses Ekzekutive të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHHPAK), kam kënaqësinë të bëj publik raportin e aktivitetit të kësaj organizate për vitin 2008.

Ky botim, është një përmbledhje e shkurtër e disa prej aktiviteteve dhe arritjeve kryesore të FSHHPAK. Raporti pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura në bashkëpunim me partnerët e bashkëpunëtorët e FSHHPAK në të gjitha nivelet.

Do të doja të theksoja se viti 2008 ka qenë një vit përpjekjesh, arritjesh pozitive në drejtim të mbrojtjes të së drejtave, përmirësimit të cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Do të doja të përshëndesja përpjekjet dhe përkushtimin e të gjithë ekipit të FSHHPAK në realizimin me sukses të objektivave tona për vitin 2008.

**Blerta Çani**  
Drejtoresh Ekzekutive

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadër të zbatimit të projektit “Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota”, mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID gjatë vitit 2008 ka vazhduar aktivitetin për të përmbushur realizimin e objektivave të këtij projekti

## Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri



- Projekti mbështet aktivitetin e punishtes “Mirësia” e vetmja këtij lloji në Shqipëri në të cilën prodhohen karrige me rrota dhe janë të punësuar 5 persona me aftësi të kufizuar, 2 prej të cileve përdorues të karrigeve me rrota. Gjatë kësaj periudhe janë prodhuar 250 karrige me rrota dhe kanë përfituar 250 persona me aftësi të kufizuara në nevojë për to, sipas specifikave individuale që ata kanë, në rajone të ndryshme të vendit.

Falë këtij projekti që nga viti 2004 e deri në përfundim të tij në Nëntor 2008 janë prodhuar 840 karrige me rrota për persona me aftësi të kufizuar.

Personave me aftësi të kufizuar të cilët janë pajisur me karrige me rrota dhe familjarëve të tyre u është ofruar informacion si për mënyrën e përdorimit të karriges me rrota ashtu edhe për çështje të cilat kanë të bëjnë me llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar.

- Në kuadër të projektit dhe me mbështetjen e USAID është mundësuar organizimi i Kampit të 10-të të Rehabilitimit Aktiv “Aftësim për jetesë të pavarur” (17-22 Shtator 2008, Mali i Robit, Resort Durrës) i cili pati për qëllim të trajnojë përdoruesit e rinj të karrigeve me rrota dhe familjarët e tyre për të fituar aftësi praktike për përdorimin e karrigës me rrota duke kontribuar për pavarësinë e tyre në jetë. Në këtë kamp rehabilitimi morën pjesë 45 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre.

- Për të parë nga afër ecurinë e aktivitetit të punishtes “Mirësia”



si dhe për të vlerësuar mundësitë e vazhdimësisë së mbështetjes së USAID për projektin e prodhimit të karrigeve me rrota më 21 tetor 2008, Znj. Roberta Mahoney, Drejtore e Misionit të USAID në Shqipëri, zhvilloi një vizitë në punishten “Mirësia”.

Znj. Mahoney u njoh me procesin e prodhimit të karrigeve me rrota si dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri për mjete lëvizëse.

- Në kuadër të këtij projekti, FSHDPAK ka lobuar fuqishëm për të siguruar mbështetjen e shtetit në subvencionimin e shërbimit të prodhimit të karrigeve me rrota në punishten “Mirësia”.

Për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit të punishtes por edhe për

të plotësuar nevojat e sa me shumë PAK në nevojë për karrige me rrota, është lobuar nga FSHDPAK përmes programit të avokatisë në nxitjen e MPÇSSHB për zbatimin e politikave subvencionuese për shërbimet në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota. Në vizitën e bërë në punishten “Mirësia” më 2 Dhjetor 2008, Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u shpreh se do të jetë në prioritetet e MPÇSSHB mbështetja e një shërbimi kaq të domosdoshëm e të kërkuar për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Megjithë këto



përpjekje ende nuk ka rezultate konkrete në këtë drejtim. Ndërkohë është lobuar për përfshirjen e biznesit në subvencionimin e prodhimit të karrigeve me rrota. Është siguruar mbështetje nga Procredit Bank dhe Fondacioni VODAFONE – Shqipëri.

### **Ngritje e kapaciteteve**

- Me qëllim implementimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar (SKPAK), FSHDPAK përmes këtij projekti ka influencuar gjithashtu në ngritjen e kapaciteteve të OJF-ve të fushës së aftësisë së kufizuar si dhe të



gjithë aktorëve përgjegjës për zbatimin e SKPAK. Në periudhën Janar – Qershor 2008 janë zhvilluar 6 trainime në 6 rajonet target të projektit (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Durrës dhe Korçë). Trainimet u fokusuan në çështjet e përshtatshmërisë dhe lëvizjes pa barriera të Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK). Pjesmarrësit në trainime ishin 94 përfaqësues/specialistë (inxhinierë, arkitektë) të institucioneve përgjegjëse të tilla

si; Bashki, Prefektura, Keshillat e Qarkut, Keshillat e Rregullimit të Territorit, Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, Drejtoritë Arsimore si dhe përfaqësues të bizneseve të ndërtimit. Në trainimin e zhvilluar në Tiranë morën pjesë gjithashtu specialistë të MPPTT. Trainimet shërbyen për të ngritur kapacitetet e aktorëve përgjegjës për zbatimin e plotikave dhe legjislacionit në fushën e përshtatshmërisë të SKPAK.



### Planet lokale për zbatimin e Planit të Veprimit të SKPAK

- Po në kuadër të ngritjes së kapaciteve por edhe të nxitjes së zbatimit të SKPAK në nivel lokal, u organizuan 5 seminare përkatësisht në rajonet Korçë, Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Elbasan. Seminaret u fokusuan në; prezantimin në nivel lokal të strukturës shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të SKPAK; rëndësinë e shtrirjes së saj në nivel lokal, gjetjet dhe rekomandimet e raportit të parë të monitorimit të SKPAK kryer nga

FSHDPAK me mbështetjen e USAID si dhe në hartimin e planeve lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK. Pjesmarrja në seminare e 167 përfaqësuesve, specialistë të institucioneve dhe subjekteve përgjegjëse për zbatimin e SKPAK në nivel lokal (Prefekturë, Bashki, Komuna, Drejtori Arsimore, Drejtori të Punesimit, Drejtori të Shëndetit Publik, Urbanistikës, OJF) dëshmoi interesin dhe rëndësinë që këto institucione i kanë dhënë

zbatimit të SKPAK. Në përfundim, u hartuan 5 plane lokale. FSHDPAK do të vazhdojë bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse në nivel lokal për miratimin dhe me pas zbatimin e planeve lokale.

- Gjithashtu në kuadër të këtij projekti dhe si një nga synimet e tij themelore ishte dhe lobimi për zbatimin e “Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar” (SKPAK) në nivel lokal. Në vijim të këtyre përpjekjeve të FSHDPAK,



në Prefekturën e Shkodrës më 23 Dhjetor 2008 nënshkruhet për herë të parë një marrëveshje bashkëpunimi nga Prefekti i Shkodrës dhe Ministri i Punëve Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me prezencën edhe të përfaqësuesve të USAID, FSHDPAK, Kryetarë të bashkive të qarkut Shkodër si dhe përfaqësues të OJF të fushës.

### **Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar**

- Zbatimi i objektivave të projektit gjate vitit 2008 konsistoi gjithashtu edhe në prezantimin e raportit të parë dhe të dytë të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK për vitin 2006. FSHDPAK me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës USAID, zhvilloi një analizë të ecurisë së Qeverisë shqiptare në zbatimin e kësaj strategjie. Kjo përpjekje u materializua në botimin e raportit



të parë dhe të dytë monitorues mbi aftësinë e kufizuar në Shqipëri, të titulluar “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar: Raporti Monitorues”, i cili përmban pesë vlerësime mbi; përshtatshmërinë, shërbimin shëndetësor, shërbimin social, arsimin, punësimin si dhe formimin profesional në gjashtë qytete

kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë e Vlorë.

- Për të bërë prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të parë të monitorimit FSHDPAK me mbështetjen e USAID organizoi me 19 Shkurt 2008 në ambientet e hotel Tirana Internacionale Konferencën “Zbatimi i

Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar. Raporti i parë i monitorimit. Gjetje dhe Rekomandime”.

Në këtë Konferencë u shpallën gjithashtu Organizatat Fituese të Çmimit “Për Arritjen më të Mirë në Zbatim të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara”.

Organizatat u përzgjedhën nga një bord ekspertesh, gjate një procesi të hapur aplikimi, mbi bazën e disa kriterëve. Çmimet, promovuan

organizatat aktive në procesin e zbatimit të strategjisë. 6 organizatat fituese; MEDPAK; Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës të Shqipërisë; shoqata “Ndihamoni Jetën”; shoqata “Për Gratë dhe Fëmijët”; shoqata “Për Rehabilitim Fizik”, shoqata “MISSAK”; me çmimin e ofruar, bënë të mundur realizimin e disa aktiviteteve specifike.

- Në vazhdim të vlerësimit të progresit të bërë në zbatim të Planit

Kombëtar të Veprimit të SKPAK më 23 Tetor 2008, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID organizoi Konferencën “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar” me qëllim prezantimin e raportit të dytë të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK, i cili përmban vlerësime mbi pesë fushat e këtij plani, në gjashtë qytete kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë e Vlorë.

Në këtë konferencë, nga Znj. Blerta Çani, drejtore Ekzekutive e FSHDPAK u bë prezantimi i gjetjeve të raportit dhe rekomandimet për veprime në të ardhmen. Gjithashtu nga përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, u prezantuan





planet e këtyre institucioneve në zbatim të SKPAK për vitin në vijim. Gjithashtu ne konferencë u prezantua modeli i qarkut të Shkodrës për zbatimin e SKPAK në nivel lokal.

Në konferencë morën pjesë; Zv. Kryeministri Z. Genc Pollo, Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Z. Anastas Duro, Znj. Roberta Mahoney, drejtore e misionit te

USAID në Shqipëri, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për problematikën e aftësisë së kufizuar, përfaqësues të OJF të aftësisë së kufizuar dhe individë me aftësi të kufizuar.

Zbatimi i projektit “Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar përdorues të karrigeve me rrota ne Shqipëri” mbështetur nga USAID ka influencuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota si dhe ka ndikuar në nxitjen e strukturave qeveritare në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Vodafone Albania, tashmë nëpërmjet Fondacionit Vodafone Albania ka mbështetur vazhdimisht gjatë 5 viteve te fundit (2003 - 2008) realizimin e prodhimit të 530 karrigeve me rrota në punishten “Mirësia”, kampingun e trajnimit të tyre, si dhe aktivitete të tjera rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri, duke u bërë një shembull i biznesit të përgjegjshëm në kontributin ndaj njerëzve në nevojë.

## **VODAFONE Albania Foundation mbështet FSHHPAK për prodhimin e karrigeve me rrota, punësimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar**

Projekti i mbështetur gjatë vitit 2008 nga Fondacioni Vodafone - Albania, bëri të mundur prodhimin dhe shpërndarjen e 50 karrigeve me rrota për persona me aftësi të kufizuar nga rajonet Durrës, Tiranë dhe Elbasan si dhe mbështetjen e Kampit të 11 të Rehabilitimit Aktiv “Aftësim për jetesë të pavarur” (10 -13 Tetor, 2008, Mali i Robit, Resort, Durrës) për persona me aftësi me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre nga të gjitha rajonet e vendit.

Për të bërë publike këtë ekperiencë 5 vjeçare bashkëpunimi, si dhe për njoftuar vazhdimësinë e mbështetjes, më 3 Dhjetor 2008, Ditën Ndërkombëtare të Aftësisë së



Kufizuar u organizua një takim me pjesëmarrjen e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtues te Vodafone-Albania, përfaqësues të Fondacionit Vodafone-Albania, përfaqësues të FSHHPAK, përfaqësues të OJF, përfitues, persona me aftësi të kufizuar.



Prej dy vjetësh, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) dhe Mobility Internacional (MIUSA) po zbaton në Shqipëri projektin “Për Ndërtimin e një Komuniteti Gjithëpërfshirës,” projekt i mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID.

Për ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës

## Iniciativa të realizuara përmes programit të granteve të vogla



Prej dy vjetësh, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) dhe Mobility Internacional (MIUSA) po zbaton në Shqipëri projektin “Për Ndërtimin e një Komuniteti Gjithëpërfshirës,” projekt i mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID.

Ky projekt ka synuar nxitjen e pjesëmarrjes së njerëzve me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në programet për zhvillim

ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe në programe të tjera zhvillimi. Gjatë vitit 2008 në kuadrin e këtij programi, u realizua dhe ofrimi i granteve të vogla për mbështetjen e projekteve dhe nismave të bashkëpunimit që synonin përbushjen e objektivit të sipërpërmendur. FSHDPAK ofroi mbështetje dhe asistencë teknike, lehtësoi bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet organizatave aplikuese për grant dhe organizatave

partnere në fushën e zhvillimit, kryesisht kontraktorë të USAID-it dhe agjenci të tjera zhvillimi që punojnë në Shqipëri. U ndihmuan OJF-të e Aftësisë së Kufizuar për të formuluar idetë e projektit, për të identifikuar dhe siguruar bashkëpunim dhe partneritete. Njëkohësisht FSHDPAK shërbeu si pikë kontakti dhe si burim informacioni për MIUSA-n për sa i përket projekt propozimeve.

#### *Projekte të zbatuara*

### **1. “Përfshirja e Femijëve me aftësi të kufizuara në arsimin publik”**

MDPKAM është një organizatë e prindërve e cila përmes këtij projekti synoi të sigurojë përfshirjen reale dhe të suksesshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara në arsimin publik. Ky projekt u zbatua në bashkëpunim me zyrën “Partners for Hope” të World Vision-it, një organizatë për zhvillim

ndërkombëtar. MDPKAM-i organizoi një fushatë ndërgjegjësuere me qëllim vendosjen e bashkëpunimit midis pushtetit vendor, Drejtorisë Rajonale të Arsimit të rrethit të Elbasanit, prindërve, mësuesve dhe specialisteve të fushës. Ky projekt përfshiu gjithashtu median lokale përmes organizimit të një debati televiziv mbi çështjet e aftësisë së kufizuar në komunitet. MDPKAM-i ofroi një sërë seminaresh për prindërit, mësuesit dhe nxënësit

në 4 shkolla me qëllim zbatimin e praktikave përfshirëse në arsim.

### **2. “Ndryshimi do të thotë Përmirësim: Përmirësohemi sëbashku, Jetojmë sëbashku”**

MEDPAK, një grup simotër avokatie në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Amerikan, kontraktor i USAID zbatuan një projekt që kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me gjithpërfshirjen e



personave me aftësi të kufizuara dhe çështje që lidhen me shëndetin dhe aftësitë e kufizuara në programet e shëndetit me anë të personelit mjekësor dhe rrjeteve të tyre vullnetare. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, MEDPAK-u organizoi një fushatë ndërgjegjësimi në Peshkopi, një qytet në veri-lindje të Shqipërisë. Tema e fushatës së ndërgjegjësimit ishte “Programe shëndetësore që përfshijnë edhe aftësinë e kufizuar”.

### **3. “Planifikimi familjar dhe edukata seksuale për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike”**

Shoqata “Ndhmoni Jetën” dhe “Shoqata e Distrofisë Muskulare”, në partneritet me “Shoqatën Shqiptare të Planifikimit Familjar” (një organizatë zhvillimi) punuan për realizimin e planifikimit familjar dhe të edukatës seksuale për personat



me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike. Takimet dhe seminarët kishin dy objektiva: ngritjen e kapaciteteve të stafit mjekësor dhe ekipeve të organizatave zbatuese dhe edukimin e të rriturve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre për trajtimin e çështjeve të seksualitetit dhe planifikimit familjar.

### **4. “Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe aftësia e kufizuar: Krijimi i një komuniteti gjithëpërfshirës biznesi”**

Projekti u zbatua nga “Shoqata Shqiptare e Invalidëve të Punës”

(ALIA), një organizatë kombëtare që nxit të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në fushat ekonomike, shoqërore, të punësimit, arsimit dhe rehabilitimit. ALIA, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHHPAK) dhe me projektin për Zhvillimin e Ndërrmarjeve dhe Shërbimeve të tregut të eksporteve (EDEM) të financuar nga USAID punuan për organizimin e seminarëve për njohjen e komunitetit të biznesit me procedurat gjithëpërfshirëse të punësimit, me legjislacionin shqiptar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ekipet e ALIA-s, FSHHPAK, EDEM, dhe ato të komunitetit të biznesit bashkëpunuan në seminare dhe takime për të diskutuar dhe zbatuar strategji që nxisin mundësitë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara.

Në nëntor 2008, me mbështetjen e “Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nërkombëtar”, “USAID”, FSHDPAK filloi një program të ri me fokus “Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore”.

## Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore



Përmes këtij projekti, FSHDPAK do të adresojë mungesën e politikave, legjislacionit apo praktikave që promovojnë pjesmarrjen mbi bazat e barazisë të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare.

Kjo do të realizohet përmes ndërhyrjeve në të gjitha nivelet; një nga drejtimet bazë do të jetë fuqizimi dhe krijimi i një rrjeti të grave me aftësi të kufizuara, që do të përbëjë një mjet të fuqishëm avokatie që do të nxisë dhe promovojë gjithëpërfshirjen e problematikës së tyre në politikat e

kuadrin ligjor relevant, njëkohësisht edhe në programet për zhvillim në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Projekti do të zbatohet për një periudhë 10 mujore, në dy qytete, Tiranë dhe Shkodër.



# **Promovim i ndryshimit në platformat politike të partive përmes dialogut të personave me aftësi të kufizuar dhe politikanëve**

Kjo iniciativë e re e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nisur në Shtator 2008, synon të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve me aftësi të kufizuar në vendimmarrjet për çështje të rëndësishme, duke ndërgjegjësuar drejtues dhe anëtarë të partive politike për atë se si përgjegjësitë e tyre si të zgjedhur lidhen me zgjidhjen e problematikave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri. Ky objektivi themelor do të

arrihet gjatë një periudhe 10 mujore përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese si dhe një vlerësimi të hollësishëm të asaj se Sa dhe Si partitë kryesore politike në Shqipëri reflektojnë në programet e tyre politike dhe elektorale nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe problematikave të fushës së aftësisë së kufizuar. Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij vlerësimi do të bëhen të njohura në vijim për partitë politike, komunitetin e personave me aftësi të kufizuar dhe publikun më gjerë.

Programi “Asistencë Ligjore dhe Avokati për Personat me Aftësi të Kufizuar”, me veprimtari në qytetet Tiranë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë, projekt i financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit për te Drejtat e Njeriut, vepron tashmë prej vitit 2004 pranë FSHDPAK.

## Asistencë ligjore dhe avokati për personat me aftësi të kufizuar



Ky program ka si mision mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

### **Si vepron programi ligjor**

*Ofron konsulencë ligjore dhe Avokat (falas) për të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara dhe familjarët e tyre*


Programi Ligjor nëpërmjet 7 avokatëve dhe juristëve, në qytetet Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Durrës asiston dhe ofron çdo ditë këshillim dhe asistencë ligjore për të gjithë PAK dhe familjarët tyre. Përfaqëson ligjërisht PAK në mbrojtje të të drejtave të tyre përpara institucioneve të Administratës Publike dhe në ato raste kur konstatohet shkelje, abuzim apo moszbatim i ligjit, PAK apo familjarët e tyre përfaqësohen ligjërisht nga

avokatët e këtij programi në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2008 Zyra ligjore ka trajtuar një numër total prej 1385 raste, nga këto Tirana 371 raste, Vloera 172 raste, Elbasan 159 raste, Durrësi 182 raste, Korça 139 raste dhe Shkodra 362 raste.

534 raste administrative janë ndjekur në Tiranë dhe në 5 qytete e tjera ku vepron Programi Ligjor. Tirana 142 raste, Durres 78 raste, Vloera 71 raste, Elbasan 63 raste Korça 53 raste Shkodra 127 raste. Në sistemin gjyqësor, gjatë vitit 2008, është ofruar përfaqësim ligjor falas për 25 raste. Nga këto në Tiranë 6 raste, Korça 5 raste, Vloera 3 raste, Shkodra 8 raste, Elbasan 2 raste



dhe Durrës 1 rast. Numri i çështjeve të trajtuara nga Zyrat e Programit Ligjor gjatë vitit 2008, janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm.



### Aktivite të Programit Ligjor gjatë vitit 2008

Zyra Ligjore ofron dhe asiston me ekspertizë ligjore, në bashkëpunim me Programin e Avokatisë, Qeverinë Shqiptare në të gjitha ndryshimet dhe përmirësimet ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar, si dhe asiston me ekspertizë ligjore shoqatat që ndërmarrin iniciativa ligjore në këtë fushë.

Programi ligjor gjatë vitit 2008 ka qenë pjesë e aktiviteteve të mëposhtme ligjore;

- Ka ndjekur procesin e hartimit të ligjit “Mbi planifikimin Urban”. FSHDPAK ka ofruar ekspertizën e saj si pjesë e grupit të ekspertëve të ngritur nga Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit. Në Dhjetor 2008 ligji “Mbi planifikimin urban” u miratua nga Parlamenti Shqiptar përfshirë edhe rekomandimet e FSHDPAK.
- Në vazhdim është ndjekur procesi i miratimit të draft statusit “Për personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike”. FSHDPAK nëpërmjet zyrës ligjore ka



koordinuar dhe ndjekur këtë proces ndërmjet insitiucioneve kompetente dhe shoqatave që veprojnë në këtë fushë. Ky draft ende nuk ka kaluar për diskutim në Parlament.

- FSHDPAK pregatiti dhe prezantoi rekomandimet ligjore në funksion të përmirësimit të Kodit të ri Zgjedhor. Përfshirja e mjeteve të përshtatshme të votimit nëpërmjet fletës brail, kutia e lëvizshme e votimit dhe sigurimi i asistencës dhe përshtatshmërisë së qendrave të votimit ishin disa nga rekomandimet kryesore



të prezantuara nga FSHDPAK. Miratimi i Kodit të ri zgjedhor përfshiu në ndryshimet ligjore vetëm realizimin e procesit të votimit nëpërmjet fletës brail, ofrimin e asistentit dhe përshtatshmërinë e qendrave të votimit.

- Nisur nga problematikat e shumta të konstatuara gjatë ankesave apo takimeve me personat me aftësi të kufizuar, programi ligjor ndërmori iniciativën për realizimin e një studim mbi procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisionet mjeksore. Programi ligjor ngriti një grup ekspertësh ligjor, përfshirë edhe avokatët e programit ligjor në rrethe. Studimi u mbështet

në mbledhjen e të dhënave sasiore nga grupet e interesit, ku u përfshinë edhe mjekët e KMCAP. Gjithashtu një rëndësi të veçantë iu kushtua analizimit të kuadrit ligjor në këtë fushë dhe krahasimin e tij me praktikatat ndërkombëtare dhe europiane. Draft-Studimi u prezantua në Dhjetor 2008 në një konferencë të organizuar nga FSHDPAK dhe është vënë në dispozicion të të gjithë aktorëve përgjegjës për plotësimin me rekomandime dhe sygjerime të mëtejshme. Programi ligjor do ta ndjekë këtë proces edhe gjatë vitit 2009.

- Programi ligjor është përfshirë në grupin e punës të ngritur nga UNICEF për realizimin e “Raportit Alternativ mbi zbatimin e Konventës së OKB për të drejtat e Fëmijëve”. FSHDPAK nëpërmjet programit Ligjor ka dhënë kontributin e saj veçanërisht në raportimin e zbatimit të nenit 23 të kësaj konvente nga Shteti Shqiptar.



Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, ka zhvilluar një sërë aktivitete të cilat kanë patur si synim integrimin e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre në jetën sociale.

## Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, Shkodër



Shërbimet e qendrës kanë qënë të fokusuar në drejtim të arsimimit të personave me aftësi të kufizuar, ku 80 fëmijë janë integruar në shkolla publike dhe vlen për t'u përmendur që 20 prej tyre janë integruar gjatë vitit të ri shkollor 2008 - 2009. Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla të zakonshme është shoqëruar edhe me informimin dhe trajnimin e mësuesve të cilët punojnë direkt me fëmijët. Gjithashtu është punuar në drejtim të integritit të personave me aftësi të kufizuar

përmes punësimit dhe për këtë qendra ka bashkëpunuar me qendra të formimit profesional dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në rajonin e Shkodrës.

Në vazhdimësi qendra ka ofruar mbështetje ligjore për personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre. Personat që kanë kërkuar ndihmë pranë kësaj qendre kanë shfaqur nevoja të ndryshme si në planin social, ashtu dhe në aspektin juridik duke përfituar edhe asistencën e kërkuar. Përkatesisht 362 persona

kane kërkuar orientim ligjor pranë qendrës vetëm gjatë vitit 2008, duke përfshirë ndihmën ekonomike, kujdestarinë, pensionin e invaliditetit, strehimin, etj. Njëkohësisht, këto persona kanë marrë këshillim, mbështetje burimore dhe sociale. Çdo të enjte, me grupin e prindërve zhvillohen pranë qendrës takimet me grupet e prindërve të cilat karakterizohen nga një pjesëmarrje e gjërë e PAK dhe familjarë. Gjatë këtyre takimeve, diskutimet kanë qenë kryesisht të përqëndruara në planin e integritetit të PAK, në jetën sociale, si dhe mbi mënyrat e zgjerimit të rrjetit dhe të bashkëpunimit në nivel lokal me institucionet përkatëse, median, etj. Rreth 50 takime janë zhvilluar gjatë vitit 2008. Aktualisht rrjeti i personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve përbëhet nga 90 persona. Në kuadër të programit “ Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore “ gjatë vitit 2008, pranë Qendrës së Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, u iniciua ngritja e grupit të grave intelektuale



me aftësi të kufizuar të qytetit të Shkodrës. Grupi i grave me aftësi të kufizuar intelektuale përbëhet nga 10 gra me aftësi të kufizuara në; shikim, në lëvizje, në të degjuar, para – tetraplegjike, etj. Krijimi i këtij grupi në qytetin e Shkodrës është mirëpritur dhe vlen për t’u theksuar fakti që për herë të parë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara mund të ndajnë dhe shkëmbejnë përvojat e tyre, përmes këtyre takimeve. Ky grupim do të



jetë në të ardhmen një zë i fuqishëm advokacie në qytetin e Shkodrës për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë aktivitetit të saj Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, Shkodër ka qënë e përfshirë në një gamë të gjërë aktiviteteve të cilat kanë kontribuar në rritjen e përgjegjësisë të aktorëve lokalë, duke synuar shërbime konkrete për persona me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre. Kjo është arritur përmes trainimeve seminareve me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe specialistëve të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal për problematikën e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu në tetor të vitit 2008 u realizua debati televiziv me temë “Problematika e aftësisë së kufizuar në rajonin e Shkodrës” me aktorë të ndryshëm nga pushteti lokal, OJF - të dhe Zyra Rajonale e Punësimit. Debatu u zhvillua pranë Tv Rozafa dhe pati një impakt mjaft pozitiv në opinionin publik të rajonit të Shkodrës.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e fondacionit SOROS mori iniciativën për zbatimin e projektit “Nxitja e përgjegjësisë sociale të komunitetit të biznesit në Shqipëri ndaj problematikës së grupeve të marginalizuara”

## Nxitja e përgjegjësisë sociale të komunitetit të biznesit në Shqipëri ndaj problematikës së grupeve të marginalizuara



Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e fondacionit SOROS mori iniciativën për zbatimin e projektit “Nxitja e përgjegjësisë sociale të komunitetit të biznesit në Shqipëri ndaj problematikës së grupeve të marginalizuara”, të bëjë një vlerësim të klimës së komunikimit dhe bashkëpunimit mes komunitetit të biznesit dhe organizatave jofitimprurëse me fokus grupet në nevojë dhe rekomandime të mundshme për ndryshim në tre rajone të vendit; Elbasan, Korçë dhe Shkodër. Në funksion të këtij vlerësimi projekti bëri aktiv



një rrjet të zgjeruar me aktorë të mundshëm për të dhënë kontributin e tyre; Drejtues dhe përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Zyrave Rajonale të Tatimeve, Zyrave Rajonale të Punës, përfaqësues të OJF, ofrues të shërbimeve për grupet vulnerabël, përfaqësues të bizneseve.

Materializimi i vlerësimi të



bashkëpunimit dhe nxjerrja e rekomandimeve për të ardhmen u bë përmes botimit të raportit “Përgjegjësia sociale e komunitetit të biznesit dhe grupet në nevojë”, i pari në vend që merr në konsideratë kontributin e biznesit në ndihmë të grupeve vulnerabël. Për t’u njohur me raportin [www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al).

Projekti gjithashtu përmes trainimeve dhe seminareve të zhvilluara në rajonet përkatëse dhe me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë, 190 perfaqesues, krijoi mundësitë për të debatuar, shkëmbyer eksperiencën dhe diskutuar në rrjet specialistësh konkluzionet dhe rekomandimet e studimit.



Për të bërë publike këtë iniciativë por edhe për të zgjeruar rrjetin e përfituesve u përgatitën dhe realizuan; 2 debate të hapura televizive, 1 spot publicitar si dhe një paketë informative.

I krijuar më Qershor 2007, duke patur tashmë në përbërje të tij 26 anëtarë, Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi ka zhvilluar një serë aktivitete për realizimin e misionit të tij për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet një bashkëpunimi aktiv dhe eficient, për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit.

## Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi



- Gjatë vitit 2008 koalicioni luajti një rol mbështetës për nisma të ndërmarra nga organizata të aftësisë së kufizuar, anëtare të tij, për realizime në fushën e përmirësimeve ligjore si edhe zbatim legjislacioni. Kështu mbështeti nismën e Grupimit

të Shoqatave të Aftësisë së kufizuar mendore, të ngritur pranë FSHDPAK, për nxitjen e qeverisë për hartimin dhe miratimin e statusit të personave me aftësi të kufizuar mendore. Koalicioni mbështeti gjithashtu nismën e Grupimit të shoqatave të organizuar



nga FSHDPAK për paraqitjen e një pakete rekomandimesh ligjore për përmirësimin e Kodit Zgjedhor për të realizuar respektimin e të drejtës së votës për të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, duke shpërndarë në rrjetin e bashkëpunëtorëve një Letër të

Hapur. Këto kërkesa u prezantuan nga drejtuesit e Koalicionit edhe në takimin me ambasadorin e OSBE z. Bosch dhe stafin e tij.

- Një Deklaratë me thirrje për moslejimin e vazhdimin të ndërtimeve me barriera për personat me aftësi të kufizuara, u shpërnda në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe në rrjetin e bashkëpunëtorëve.
- Koalicioni në fillim të viti 2008 diskutoi dhe miratoi një Aneks – Marrëveshje e cila u firmos nga organizatat anëtare, themeluese të Koalicionit si edhe zgjedhi strukturat drejtuese të tij dhe përgatiti e miratoi një plan aktivitetesh për periudhën janar 2008 – qershor 2009.
- Për të nxitur strukturat shtetërore për përfshirje gjithnjë e më gjerë të problematikave të aftësisë së kufizuar në politikat e tyre, Koalicioni në takimin e organizuar në Qershor 2008, ftoi drejtorin e Shërbimeve Sociale në MPCSSHB, i cili prezantoi arritjet

më të fundit të institucionit në fushën e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara si edhe sfidat për të ardhmen. Pjesë e grupit përfaqësues në një vizitë studimore në Irlandë, mbështetur nga USAID, ishin edhe disa organizata anëtare të Koalicionit. Kjo vizitë u vlerësua shumë e domosdoshme dhe e suksesshme sidomos në përfitimin e eksperiences nga organizatat anëtare të Koalicionit që nuk kanë në fokus çështjet e aftësisë së kufizuar, duke i nxitur për të gjetur hapësira gjithpërfshirëse brenda programeve të tyre.

- Koalicioni ka vazhduar punën për ndërtimin dhe funksionimin e një faqe interneti, për një logo të tij, për hartimin e një reviste ku anëtarët të mund të marrin dhe të prezantojnë informacione. Këto aktivitete si edhe realizimi i dy takimeve të ardhëshme do të mundësohen falë mbështetjes financiare të siguruar nga World Learning/ FORECAST.

Fillimi i reformës zgjedhore dhe ngritja e Komisionit parlamentar për këtë çështje, nxiti sërish FSHDPAK, mbështetur nga Instituti Republikan Ndërkombëtar, për të ndërmarrë nismën për përgatitjen e një pakete me rekomandime ligjore për përmirësim të Kodit Zgjedhor.

## Reforma zgjedhore dhe Aftësia e Kufizuar

Kjo paketë përfshiu rekomandime konkrete për të mundësuar përfshirjen në proces votimi të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë të gjithë zgjedhësve me aftësi të kufizuar. Paketa iu dërgua komisionit të reformës zgjedhore dhe më tej komisionit të Kodit Zgjedhor, me kërkesën për ta bërë atë pjesë të ndryshimeve ligjore të Kodit të Ri.

FSHDPK dhe përfaqësues të Grupimit “Për përmirësimin e Kodit Zgjedhor” organizuan në zyrën e FSHDPAK një takim me kryetarin e KQZ Z.Çlirim Gjata. Organizatat i kërkuan Z.Gjata që KQZ të përgatisë dhe të shpërndajë një informacion me të

dhëna për QV aktuale, aktualisht vendndodhjen e më pas nivelin e tyre të përshtatshmërisë. Gjithashtu u kërkua që në fushatën më të afërt zgjedhore KQZ të përfshijë në hapësirat publicitare çështjen e evidentimit dhe rregjistrimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe të parashikojë buxhet shtesë për disa përmirësime administrative në lidhje me aftësinë e kufizuar. U zhvillua një takim me Drejtorin e Pergjithshëm të Gjendjes Civile dhe iu kërkua mbështetje për gjetjen e mënyrave dhe mjeteve, duke bashkëpunuar edhe me pushtetin vendor, për evidentimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar.

Përfaqësues të Grupimit të shoqatave “Për përmirësimin e Kodit Zgjedhor”, morën pjesë në takimin që Lëvizja Socialiste për Integrim organizoi në përgjigje të “Letrës së hapur” që ky grupim shpërndau. Drejtuesit e LSI mbështetën kërkesat e paraqitura dhe u angazhuan që t’i paraqesin ato në momentin e hartimit të kodit të ri zgjedhor. Në takimin e organizuar me Ambasadorin e OSBE, z. Bosch dhe stafin e tij u paraqitën përpjekjet që FSHDPAK po bën për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së votës për zgjedhësit me AK. Ambasadori i Prezencës dhe përfaqësuesit e tjerë të OSBE,

pjesëmarrës në takim vlerësuan punën e bërë nga FSHDPAK dhe u ra dakort që të organizohet një tryezë me të gjitha organizatat e aftësisë së kufizuar, për të diskutuar më tej për një paketë të përbashkët rekomandimesh. Tryeza e mbështetur nga OSBE dhe bashkëpunimin e INSIZ, në të cilën morën pjesë të gjitha shoqatat e fushës së aftësisë së kufizuar, u organizua në Qershor 2008. Në tryezë pjesëmarrësit u njohën më paketën me rekomandime ligjore të përgatitura nga FSHDPAK si edhe me një material me disa sugjerime të paraqitura nga Këshilli Kombëtar i personave me aftësi të kufizuar.

Paketa e rekomandimeve, e përgatitur nga FSHDPAK, ku u përfshinë edhe sugjerimet e Këshillit, iu dërgua sërish Komisionit të Reformës Zgjedhore. Më tej përfaqësues të FSHDPAK organizuan dhe zhvilluan takime individuale ndërgjegjësuese me anëtarët dhe bashkëkryetarët e Komisionit, si edhe me ekspertët e këtij komisioni. Përfaqësuesi i FSHDPAK u ftua për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore në Komisionin e Kodit Zgjedhor, e zhvilluar me grupet e interesit, për të bërë prezente dhe për të mbrojtur kërkesat për amendime ligjore të paraqitura pranë këtij komisioni.

## Ofrimi i Shanseve të barabarta për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri



15 muaj pas aprovimit të Standardeve të Shërbimeve Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Qëndrat Ditore dhe Rezidenciale, (Vendim të Këshillit të Ministrave, nr 822, datë 12/06/06/.) Fondacioni Shqiptar për te Drejtat e Personave me

Aftësi të Kufizuara, realizoi një vëzhgim “Hapa të Vegjël”, me synim për të analizuar hapat e ndërmarë dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e tyre në qendrat ditore dhe rezidenciale që ofrojnë shërbime ndaj klientëve me aftësi të kufizuara

mendore, si dhe respektimin e të drejtave të tyre brenda kuadrit të standardeve.

Vëzhgimi u realizua gjatë periudhës Shkurt - Prill 2008, dhe u shtri në 26 qendra ditore dhe rezidenciale (publike dhe private) në mbarë vendin të cilat ofrojnë shërbime për 564 persona me aftësi të kufizuara mendore.

Në vëzhgim u përfshinë përmes intervistave, diskutimeve në grup, plotësimit të pyetësorëve si dhe formularëve të vëzhgimit, klientë të të gjitha grup moshave, pjesëtarë të familjeve të klientëve të qendrave ditore e rezidenciale, staf i qendrave ditore e rezidenciale si dhe drejtuesit e këtyre qendrave. Pjesë e rëndësishme e vëzhgimit ishte dhe studimi i dokumentacionit përkatës në ndihmë të zbatimit të standardeve.

Gjetjet kryesore të vlerësimit bëjnë të njohura fakte në lidhje me një nivel të mirë të njohjes së standardeve nga stafet dhe drejtuesit e qendrave, por ritme të ulta në drejtim të fillimit të planifikimit të punës për zbatimin e tyre. Situata aktuale në qendrat e zhvillimit (të fokusuar kryesisht tek personat me aftësi të kufizuara mendore) krahasuar me kriteret që përcaktojnë zbatimin e standardeve, paraqitet paksa kënaqshëm për sa i përket vlerësimit dhe hartimit të planeve individuale; promovimit të pavarësisë, gjithëpërfshirjes dhe vetë vendosjes; trajtimit të barabartë dhe procesit të ankimimit.

Gjithë procedurat e shërbimit për qendrat e zhvillimit, duhet të rishkruhen për të reflektuar kriteret e përcaktuara në standarde. Procedurat e reja

duhet të përfshijnë procesin e monitorimit të shërbimit. Mbetet ende shumë për tu bërë, që të mundësohet që gjithë personat me aftësi të kufizuara, përfitues të shërbimeve sociale në qendrat ditore dhe rezidenciale të gëzojnë të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike mbi bazat e barazisë sikurse gjithë bashkëmoshatarët e tyre, si dhe tu garantohet mbrojtja nga çdo lloj shfrytëzimi apo abuzimi. Për të garantuar respektimin e të drejtave është e nevojshme që çdo qëndër të përfshijë ato në politika dhe procedura të shkruara. Realizimi i këtij studimi u bë i mundur përmes mbështetjes financiare të Cordaid, në kuadrin e programit të FSHDPAK për “Ofrimin e Shanseve të Barabarta për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri”.

## Botime

Gjatë vitit 2008, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka publikuar:

- Raport i parë i monitorimit “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara”.
- Raporti i dytë i monitorimit “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara”.
- Raport vlerësimi “Hapa të vegjël – Vlerësim formativ mbi zbatimin e Standarteve për Shërbimet Sociale për individët me aftësi të kufizuara në qendrat ditore dhe rezidenciale dhe realizimi i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut”.
- Raport vëzhgimi “Përgjegjësia sociale e biznesit dhe grupet e marginalizuara në shoqëri”.
- Botimi “Draft-Studimi i kuadrit ligjor mbi komisionimin e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”.
- Broshura shpjeguese mbi të gjitha ndryshimet ligjore të ndodhura gjatë vitit 2008 në fushën e aftësisë të kufizuara.
- Raport vjetor 2007.
- Ribotim të përditësuar të Paketës Ligjore në fushën e aftësisë së kufizuara.
- Revista “Sfida” në versionin elektronik, realizuar në numrat 27 dhe 28.

# Bilanci i F.SH.D.P.A.K

më 31 Dhjetor 2008  
dhe 2007  
(vlerat në Euro)

	<i>December 31, 2008</i>	<i>December 31, 2007</i>
<b>Aktive Qarkulluese</b>		
Inventar	43,105.35	25,082.00
Diferenca nga konvertimi	0.00	250.00
Arka dhe Banka	52,030.1	115,223.00
	<b>95,135.45</b>	<b>140,555.00</b>
<b>Aktive Fikse</b>		
Aktive Fikse të Qendrueshme		
Toka, Ndërtesa	280,181.99	294,430.00
Furnitura, Pajisje	53,237.16	64,892.00
	<b>333,419.14</b>	<b>359,322.00</b>
<b>Aktive Totale</b>	<b>428,554.59</b>	<b>499,877.00</b>
<b>Detyrime Afatshkurtra</b>		
Llogari të pagueshme	536.82	0.00
Të pagueshme ndaj pundonjesve dhe		
sigurimet shoqërore	1,243.53	2,503.00
Detyrime Tatimore	732.42	610.00
Diferenca nga konvertimi	0.00	563.00
	<b>2,512.78</b>	<b>3,676.00</b>
<b>Kapitali i vet</b>		
Gjëndja në fillim te vitit	497,993.88	494,063.92
Fitim (humbja) e vitit	(71,952.07)	2,137.08
	<b>426,041.81</b>	<b>496,201.00</b>
<b>Total detyrime dhe kapitali</b>	<b>428,554.59</b>	<b>499,877.00</b>

# Projekte të FSHDPAK gjatë vitit 2008

<i>Emri i Projektit</i>	<i>CORDAID</i>	<i>USAID</i>	<i>SHC</i>
<b>A. Balanca fillestare me 01.01.2008 (banke&amp;arke)</b>	61,787.74	23,274.00	1,059.82
<b>B. Të ardhurat</b>	52,000.00	156,469.93	60,000.00
<b>TOTAL</b>	<b>113,787.74</b>	<b>179,743.93</b>	<b>61,059.82</b>
<b>C. Shpenzimet</b>			
Qera/Blerje zyre ADRF/Mirëmbajtje/Mallra konsumi	5,835.67	9,932.52	3,856.00
Botime/Kancelari/Pajisje zyre	1,031.00	8,223.54	6,437.00
Ndërgjegjesim/Reklamë/Prodhim			
Informacioni/Studime/Trajnime	21,108.40	59,726.32	6,381.00
Personel	50,798.46	46,663.96	34,634.00
Komunikim/E-mail/Internet	969.61	3,205.55	1,823.00
Transport/Naftë/Mirëmbajtje makina&makineri	1,022.70	6,439.55	1,880.00
Komisione Bankare	31.80	438.37	40.00
Lëndë të para dhe mallra ndihmëse		26,744.89	
Dieta/Shërbime Konsulence/Koordinim			
lokal/Pagesa për trajnim	31,281.60	18,205.03	4,858.00
<b>TOTAL</b>	<b>112,079.24</b>	<b>179,579.73</b>	<b>59,909.00</b>
<b>Balanca më,31.12.2008 (banka&amp;arka)</b>	<b>1,708.50</b>	<b>164.20</b>	<b>1,150.82</b>

<i>UNICEF</i>	<i>GTZ</i>	<i>IRI</i>	<i>Vodafone</i>	<i>MIUSA</i>	<i>Forecast/World Learning</i>	<i>Fondazioni Soros</i>	<i>Us Embassy</i>	<i>Aids (Ndihma)</i>	<i>ADRF contribution</i>	<i>Total</i>
		119.00		2,141.00					26,900.00	115,281.56
7,385.00	3,369.14	3,930.30	34,987.58	1,781.08	1,633.98	19,667.89	4,585.35	655.05	9,051.74	355,517.04
<b>7,385.00</b>	<b>3,369.14</b>	<b>4,049.30</b>	<b>34,987.58</b>	<b>3,922.08</b>	<b>1,633.98</b>	<b>19,667.89</b>	<b>4,585.35</b>	<b>655.05</b>	<b>35,951.74</b>	<b>470,798.60</b>
			1,088.00			753.96	288.22		547.38	22,301.75
679.94					98.04		258.09			16,727.61
3,374.26			8,483.00		436.07	15,064.85				114,573.90
1,293.95			4,684.00		588.24	1,563.61	1,729.33	655.05	1,800.33	144,410.93
677.00			122.00		147.06	1,004.85	423.16			8,372.23
1,360.00			836.00		107.84	550.89	411.37		264.71	12,873.06
			12.00	61.22	6.25	39.96	22.08			651.68
			2,954.00						1,445.42	31,144.31
	3,369.14	3,930.00		1,735.88		670.77			3,662.61	67,713.03
										0.00
<b>7,385.15</b>	<b>3,369.14</b>	<b>3,930.00</b>	<b>18,179.00</b>	<b>1,797.10</b>	<b>1,383.50</b>	<b>19,648.89</b>	<b>3,132.25</b>	<b>655.05</b>	<b>7,720.45</b>	<b>418,768.50</b>
<b>-0.15</b>	<b>0.00</b>	<b>119.30</b>	<b>16,808.58</b>	<b>2,124.98</b>	<b>250.48</b>	<b>19.00</b>	<b>1,453.10</b>	<b>0.00</b>	<b>28,231.29</b>	<b>52,030.10</b>



"INTER B.B.K. Auditing" sh.p.k.

## AUDITOR'S REPORT

To the Executive Director of  
**Albanian Disability Rights Foundation**  
Tirana, Albania

We have audited the accompanying financial statements of Albanian Disability Rights Foundation Tirana - Albania (the Organization), which comprise the balance sheet as at 31 December 2008 and the statements of income and expenditures, statement of changes in fund balance and cash flow statement for the year than ended and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

### *Management's Responsibility for the Financial Statements*

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with National Accounting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud and error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

### *Auditor's Responsibility*

Our responsibility is to express an independent opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. These procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risk of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

*A member firm of Moore Stephens International Limited - members in principal cities throughout the world*



"INTER B.B.K. Auditing" sh.p.k.

### *Opinion*

In our opinion, the financial statements give a true and fair view, in all materials respects, the financial position of Albanian Disability Rights Foundation Tirana, as of 31 December 2008, and of its financial position and its cash flows for the year than ended in accordance with Law 9228 dated 29.04.2004 "On Accounting and Financial Statements" and other the Albanian Regulations.

This report is intended solely for the information and use of the organisation's management, the management of CORDAID and other donors, and is not intended and should not used by anyone other than these specified parties.

"Inter BBK - Auditing" Ltd

Tirana June 17<sup>th</sup>, 2009

Esmeralda BALLUKU

Partner



*A member firm of Moore Stephens International Limited - members in principal cities throughout the world*

